



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 07/L - 036

**PËR RATIFIKIMIN E KONTRATËS FINANCIARE, NDËRMJET
REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE BANKËS EVROPIANE PËR
INVESTIME PËR PROJEKTIN E IMPIANTIT TË UJËRAVE TË ZEZA
NË GJILAN**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të neneve 18 dhe 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

**LIGJ PËR RATIFIKIMIN E KONTRATËS FINANCIARE, NDËRMJET
REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE BANKËS EVROPIANE PËR
INVESTIME PËR PROJEKTIN E IMPIANTIT TË UJËRAVE TË ZEZA
NË GJILAN**

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim që të ratifikojë kontratën financiare, ndërmjet Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për projektin e impiantit të ujërave të zeza në Gjilan, nënshkruar më 28 maj 2020.

Neni 2
Ratifikimi i Marrëveshjes

Nëpërmjet këtij ligji ratifikohet kontrata financiare, ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për projektin e impiantit të ujërave të zeza në Gjilan, nënshkruar më 28 maj 2020.

Neni 3
Dokumentet e bashkëngjitura

Në shtojcën e këtij Ligji është Kontrata Financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për projektin e impiantit të ujërave të zeza në Gjilan.

Neni 4
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 07/L-036
28 dhjetor 2020

Arbërie NAGAVCI

Nënkryetare e Kuvendit